



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

SHOQËRIA "ALBPETROL" SH.A.

DREJTORIA E PROKURIMIT DHE ANKANDIT

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____08.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Shërbim për monitorimin e mjedisit"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 90711500-9
monitorimi I mjedisit përveç për ndërtim

VLERA E FONDIT LIMIT: 12,626,667 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor Albpetrol sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës3;*

b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Kapaciteti ligjor plotësohet duke dorëzuar dokumentat sipas Kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit

2.1.1.1. Licensë III.2.A lëshuar nga QKB për operatorin ekonomik për hartimin e raporteve të vlerësimit në mjedis, kryerje auditi mjedisor, veprimtari ekspertize për ndikime në mjedis. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili nga operatorët duhet të paraqesë licencën e mësipërme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë dhe AK të sigurohet se ofertuesi është i licencuar në kryerjen e monitorimit të mjedisit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje te certifikuar te bilancit për vitet financiare 2020, 2021, 2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të konfirmuar nga administrata tatimore

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2.2. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Shërbime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se: 40 % e fondit limit objekt prokurimi, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen të paraqiten:

Vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasinat e shërbimeve të furnizuara.

OSE

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasinat e shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Për të vërtetuar që operatori ekonomik ka kapacitete njerëzore profesionale të mjaftueshme për realizimin në kohë e cilësi të kontratës, duhet të ketë staf teknik minimalisht 6 (gjashtë) punonjës. Për këtë të paraqitet:

- Vërtetim nga administrata tatimore për numrin mesatar të punonjësve për të paktën tre muajt e fundit.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

2.3.3. Punonjësit e stafit teknik duhet të jetë i certifikuar/trajnuar në fushat e mëposhtëme:

- Të jetë i certifikuar për auditimin e efikasitetit të energjisë në procese energjetike.
- Të jetë i certifikuar dhe të njohë standartet ISO 1996-2:2017 dhe ISO 9612:2009 ose të përditësuara për vlerësimin e zhurmës në mjedis dhe zhurmës në vendin e punës.
- Të jetë i certifikuar për planet e menaxhimit të emergjencave mjedisore.
- Të jetë i certifikuar për menaxhimin e mbetjeve.
- Të jetë i certifikuar në planet e menaxhimit mjedisor dhe rehabilitimeve mjedisore.

Pranohen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë, por që në mënyrë të kombinuar stafi të plotësojë minimumin e certifikatave/dëshmimeve të kërkuara.

Për secin punonjës të paraqiten:

- Certifikata përkatëse.
- Listepagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit në të cilat punonjësit me certifikatat e sipërpërmendura duhet të figurojnë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për punonjës të certifikuar janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Kërkesat për punonjësit e mësipërm janë hartuar duke iu referuar termave të referencës dhe kërkesave në lejet mjedisore qw do të monitorohen.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën persona të kualifikuar si më poshtë:

- Të paktën 1 (një) punonjës Inxhinier mjedisi.
- Të paktën 1 (një) punonjës ekspert me përvojë në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Të paktën 2 (dy) punonjës kimist.
- Të paktën 2 (dy) punonjës eksperte mjedisi të certifikuar.

Për secilin specialist të paraqiten:

- Diploma e arsimit të lartë.
- Për ekspertët e mjedisit të paraqiten certifikatat përkatëse të lëshuara nga organi kompetent.
- Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, në të cilat inxhinierët dhe specialistët e cituar duhet të figurojnë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për karta specialistw janë kërkuar në bazë të pikës 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë gjithashtu minimalisht një Inxhinier naftë/gjeolog, i punësuar pranë operatorit ekonomik ose me kontratë shërbimi.

Për këtë të paraqiten:

- Diploma e arsimit të lartë.
- Listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, ose kontrata e shërbimit me afat jo më të shkurtër se periudha që do të ofrohet shërbimi që prokurohet e shoqëruar me diplomën e arsimit të lartë.

Shenim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat për inxhinierin e naftës/gjeolog wshtw e bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ku nëpërmjet këtij kriteri provohet se operatorët ekonomikë provojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. Albpetrol sh.a duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për zbatimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

2.3.6. Certifikatë ISO 9001:2015 ose e perditesuar (per sistemet e menaxhimit te cilesise), e vlefshme, e operatorit ekonomik, ose ekuivalente, leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

2.3.7. Certifikatë ISO 14001:2015 ose e perditesuar (per sistemet e menaxhimit te mjedisit), e vlefshme, e operatorit ekonomik, ose ekuivalente, leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i

akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

- 2.3.8. Certifikatë ISO 45001:2018 ose e perditesuar (per sistemet e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune), e vlefshme, e operatorit ekonomik, ose ekuivalente, leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise.

Shënim: Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili nga operatorët duhet të paraqesë Isot e kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtyre kërkesave AK kërkon të sigurohet që ofertuesit ushtrojnë aktivitetin dhe janë të certifikuar në përputhje me kërkesat e menaxhimit cilësisë menaxhimit të mjedisit dhe menaxhimit të shendetit dhe sigurise ne pune dhe këto kriteret të vendosura janë në përputhje të plotë me objektin e prokurimit.

2.3.9. Operatori ekonomik duhet te disponoje:

- Laborator te akredituar nga Drejtorja e Pergjithshme e Akreditimit sipas ISO 17025:2017, te pakten 1(nje), per monitorimin e cilesise se ajrit, ujit dhe monitorimin e zhurmave, sipas termave te references, i cili te jete ne pronesi ose me qira.

Për këtë të paraqiten:

- Certifikata e akreditimit te laboratorit leshuar ne emer te operatorit ekonomik.
- Nese laboratorit është me qira ose me kontrate bashkepunimi te paraqitet kontrata e qirase ose e bashkepunimit e lidhur para noterit, me afat jo më te shkurter se periudha qe do te ofrohet sherbimi se bashku me certifikaten e akreditimit.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

- Automjet transporti punonjësish te pakten 1(nje).

Për këtë të paraqiten:

Leja e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt kolaudimi të vlefshëm, taksat vjetore të paguara. Në rastin kur automjeti është me qira, përvec dokumentave të sipërcituar duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e lidhur para noterit, me afat jo më të shkurtër se periudha që do të ofrohet shërbimi.

Shënim: Për përmbushjen e këtij kriteri operatorët ekonomik ofertues duhet te paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojces nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzoje pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4 gërma ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Ky kriter shërben për të treguar kapacitetin teknik lidhur me mjetet në dispozicion të ofertuesit për të realizuar me sukses kontratën pasi sipas termave të kontratës ofertuesit duhet të kryejnë monitorimin e ajrit, ujit dhe zhurmave në mjedis.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistet e fushës të cilët kanë njohuri të posaçme për objektin e prokurimit.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njesia e prokurimit: